



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2014
Nr.ref.:RK626/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI160/13

Parashtrues

Desa Aleksić

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-II- 12-006, të Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 30 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Desa Aleksić (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga z. Muhamet Shala, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme), AC-II- 12-006, të 30 majit 2013. Parashtruesja e kërkesës e ka pranuar këtë aktgjykim më 12 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme, AC-II- 12-006, të 30 majit 2013, me të cilin ankesa e së paditurës (AI “Kosova-Export”, NSH “Bujqësia” nga Fushë-Kosova) e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ishte pranuar si e bazuar. Të njëjtën kohë ishte anuluar Aktgjykimin i Gjykatës Komonale në Prishtinë, P. nr. 550/08, i 20 prillit 2010.
4. Sipas parashtrueses së kërkesës, aktgjykimin i kontestuar ishte marrë me shkelje të *“kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të përcaktuar me kapitullin VII, nenin 102, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”*. Parashtruesja e kërkesës më tutje pretendon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se i janë shkelur të drejtat e saj pronësore, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 tetor 2013, parashtruesja e dorëzoi kërkesën përmes postës rekomande në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Kërkesa ishte pranuar më 16 tetor 2013.
7. Më 31 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI160/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI160/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
8. Më 12 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe kërkoi nga ajo të dorëzojë autorizimin për avokatin Muhamet Shala nga Prishtina.
9. Më 12 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 4 dhjetor 2013, avokati Muhamet Shala e dorëzoi autorizimin, dhënë atij nga parashtruesja e kërkesës.
11. Më 27 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më tej është përmbledhja e fakteve, siç pretendohet nga parashtruesja në kërkesën e saj dhe e shtjelluar në aktgjykimin e kontestuar të bashkëngjitur.
13. Më 20 shkurt 2008, parashtruesja e kërkesës paraqiti padi në Dhomën e Posaçme, duke kërkuar që të anulohet kontrata e shitjes së pronave të paluajtshme, OV. NR. 3039/63, të 21 nëntorit 1963, të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, të lidhur në mes të paraardhësit të parashtrueses së kërkesës, babait të saj (tani i ndjerë), Mile Vukmirović dhe AIC “Kosmet-Export”.
14. Më 12 mars 2008, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, me Vendimin SCC-08-0044, i referohet padisë së parashtrueses së kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke i udhëzuar palët që në rast të ankesës kundër vendimit ose aktgjyimit, ajo duhej të ushtrohej në Dhomën e Posaçme.
15. Më 20 prill 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin P. nr. 550/08, e aprovoi padinë e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi se kontrata e shitjes së pronës së paluajtshme OV. Nr. 3-39, e 21 nëntorit 1963, është e pavlefshme, dhe e obligoi të paditurin AIC “Kosmet-Export” t’ia kthejë pronësinë dhe posedimin paditëses, si trashëgimtare e radhës së parë dhe t’i lejojë parashtrueses ta regjistrojë pronën e kontestuar në emrin e saj.
16. Më 5 gusht 2010, i padituri e dorëzoi me kohë ankesën kundër Aktgjyimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 550/08, të 20 prillit 2010. Në ankesë, i padituri pretendonte, *inter alia*, se gjykata e shkallës së parë do të duhej të kishte kontrolluar nëse padia për anulimin e kontratës është paraqitur me kohë, pasi që kontrata e shitjes ishte lidhur më 23 nëntor 1963, përderisa padia për anulimin e kontratës është dorëzuar më 2009, rrjedh se paditësi nuk i ka shfrytëzuar afatet ligjore, prandaj padia si e tillë do të duhej të hidhej poshtë si e pabazuar.
17. Më 25 qershor 2012, Kolegji i Ankesave ia dorëzoi parashtrueses së kërkesës ankesën dhe dokumentet përcjellëse, në mënyrë që të dorëzonte një përgjigje në ankesë.
18. Më 8 gusht 2012, parashtruesja e kundërshtoi ankesën e të paditurit në tërësi dhe i propozoi Dhomës së Posaçme të hedhë poshtë ankesën e të paditurit, si të pabazuar, ta vërtetojë aktgjykimin e ankimuar, sepse sipas parashtrueses së kërkesës, ai aktgjykim është shumë i qartë, i kuptueshëm dhe i bazuar në ligj.
19. Më 30 maj 2013, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin nr. AC-II- 12-006. Sipas arsyetimit ligjor të atij aktgjykimi, “Aktgjykimi i ankimuar

i Gjykatës Komunale në Prishtinë nuk është i drejtë në pikëpamje të rezultatit dhe të arsytimit juridik, prandaj, duhet të anulohet”.

20. Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme më tej theksoi se *“Gjykata e shkallës së parë nuk e ka konstatuar në mënyrë të drejtë dhe complete gjendjen faktike në aktgjykimin e ankimuar dhe, për pasojë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, kur në tërësi e ka miratuar padinë e paditëses si të bazuar dhe e ka anuluar kontratën për shitblerjen e paluajtshmërisë. Gjykata nuk e ka refuzuar padinë si të pabazuar, edhe pse është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar me ligj”.*
21. Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme shtjelloi më tej se parashtruesja e kërkesës *“ka theksuar se kontrata është lidhur nën presion dhe me kërcënime serioze, (ndërsa supozon se ka munguar vullneti i paraardhësit të paditëses për lidhje të kontratës) dhe edhe po të zbatoheshin këto dispozita, të cilat në këtë rast nuk mund të zbatohen, ashtu siç është thënë më parë, zbatimi i tyre nuk është i rregullt. Prandaj, vetëm dispozitat e nenit 11 të LMD të cilat i rregullojnë kontratat e rrëzueshme (pavlefshmëria relative) mund të zbatohen në lëndën konkrete, e jo neni 103 dhe 104 i LMD (i cili e rregullon pavlefshmërinë absolute të kontratave) që parashohin pavlefshmëri të kontratave të lidhura në kundërshtim me parimet e caktuara kushtetuese të rregullimit publik, dispozitat detyruese dhe zakonet e mira, prandaj, kjo kontratë nuk është përcaktuar me asgjë që është në kundërshtim me vlerat e përmendura të sistemit gjyqësor-kushtetues të asaj kohe. Në bazë të kësaj, për arsye të lartpërmendura dhe në bazë të nenit 10.10 të Ligjit për Dhomën e Veçantë, është vendosur si në dispozitiv”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës pohon se pavarësisht se Republika e Kosovës nuk e ka miratuar ligjin për kthimin e pronës private që është marrë gjatë regjimit socialist, në rastin konkret Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa) duhet të jetë drejtpërdrejt e zbatueshme, në veçanti e drejta e kthimit të pronës private, sipas parashtrueses së kërkesës, është e garantuar me Konventë.
23. Prandaj, parashtruesja e kërkesës e konteston zbatimin e Ligjit për marrëdhënie detyrimore, i cili sipas saj, është në kundërshtim me Konventën. Parashtruesja më tej pretendon se kontrata për shitje, e nënshkruar nga paraardhësi i parashtrueses së kërkesës, *“mund të njihet si asgjë tjetër, por si kontratë e një shteti totalitar, dhe duhet të konsiderohen si absolutisht e pavlefshme, ... në pajtim me Konventën”.*
24. Parashtruesja më tej pretendon se *“nuk është kontestuese se që nga viti 1990, një numër i madh i qytetarëve e kanë fituar këtë të drejtë në mënyrë institucionale, në procedurë administrative ose gjyqësore, në bazë të anulimit të kontratave të shitjes së pronës së paluajtshme. Prandaj, tani kemi kategorinë e qytetarëve siç është Desa Aleksic, e cila në krahasim me qytetarët tjerë, është diskriminuar në realizimin e të drejtave të saj pronësore dhe të kthimit”.*

25. Parashtruesja gjithashtu pretendon se Dhoma e Posaçme në rastet e ngjashme ka vendosur ndryshe nga rasti i parashtrueses, dhe në këtë drejtim, e ka bashkëngjitur kopjen e Vendimit në rastin SCA-08-0042, ku ankesa e AKP-së është hedhur poshtë si e papranueshme.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses së kërkesës, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

27. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se esenca e ankesave të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të së drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të drejtën pronësore, të dyja të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventë.

- Sa i përket ankesës së parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës së saj për gjykim të drejtë:

28. Gjykata vëren se parashtruesja nuk pajtohet me gjetjet e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme dhe pretendon se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme e ka zbatuar gabimisht Ligjin për marrëdhëniet detyrimore.

29. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

30. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

31. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1; shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011*).

32. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligjin për procedurën kontestimore, duke ushtruar ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme e mori këtë parasysh dhe vërtet iu përgjigj ankesave të saj në çështjet ligjore.

33. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria, ose që procedurat kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta (shih, *mutatis mutandis*, *Shub vs. Lituania*, ECtHR, Vendimi për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
34. Sa i përket ankesës së parashtrueses së kërkesës se një numër i madh i qytetarëve e kanë fituar këtë të drejtë në mënyrë institucionale, në procedurë administrative ose gjyqësore, në bazë të anulimit të kontratave të shitjes së pronës së paluajtshme dhe se është diskriminuar në realizimin e të drejtave të saj pronësore dhe të kthimit, Gjykata vëren se parashtruesja nuk i ka argumentuar pretendimet e saj. Dëshmia e vetme në mbështetje të pretendimeve të parashtrueses, e bashkëngjitur në kërkesën e saj, gjegj. Vendimi i Dhomës së Posaçme në rastin SCA-08-0042, nuk është relevante, pasi që në atë rast, ankesa e AKP-së ishte refuzuar si e paafatshme.

- Sa i përket ankesës së parashtrueses lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtave të saj pronësore

35. Parashtruesja më tej kërkoi nga Gjykata të deklarojë aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të pavlefshëm pasi që kontrata që i ati i saj i ndërë e kishte nënshkruar në vitin 1963, nuk është “... asgjë tjetër përpos kontratë/kontrata të një shteti totalitar, dhe duhet të konsiderohet si absolutisht e pavlefshme, ... në përputhje me Konventën”.
36. Gjykata vëren se parashtruesja iu referohet ngjarjeve që kishin ndodhur në vitin 1963.
37. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të përcaktojë juridiksionin e saj kohor.
38. Gjykata rikujton se, sipas rregullit 36 të Rregullores së punës të Gjykatës, “*Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën*”.
39. Kriteri i ngjashëm për pranueshmëri është zbatuar nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut.
40. Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, “*Mohimi i pronësisë apo ndonjë të drejte tjetër in rem është në parim një veprim i menjëhershëm dhe nuk prodhon një situatë të vazhdueshme të "mohimit të një të drejte"* (shih *Malhous kundër Republikës Çeke* (vendim) [DHM], nr. 33071/96, GJEDNJ 2000-XII, me referenca të mëtejshme).
41. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se ajo nuk mund merret me një kërkesë, që ka të bëjë me ngjarjet që kishin ndodhur para hyrjes në forcë të Kushtetutës, gjegj. para 15 qershorit 2008 (shih, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës, në rastin nr. 18/10, *Denic et al*, të 17 gushtit 2011).
42. Në bazë të asaj çka u tha më lart, kërkesa e parashtrueses në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave pronësore lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur para 15 qershorit 2008, nuk është *ratione temporis*, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

43. Për më tepër, Gjykata përsërit se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut "neni 1 i Protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet si vendosje e ndonjë detyrimi të përgjithshëm të Shteteve Kontraktuese për të kthyer pronën që iu ishte transferuar atyre para se ata e ratifikuan Konventën. Neni 1 i Protokollit nr. 1 as nuk imponon kufizime në lirinë e Shteteve Kontraktuese për të përcaktuar qëllimin e kthimit të pronave dhe për të zgjedhur kushtet në të cilat ata pajtohen për të rivendosur të drejtat pronësore të ish-pronarëve" (shih Jantner kundër Sllovakisë, nr. 39050/97 § 34, 4 mars 2003).
44. Duke marrë parasysh të gjitha ato që u përmendën më lart, Gjykata konstaton se kërkesa nuk i plotëson kriteret për pranueshmëri në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (1) c) dhe h) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe h) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 27 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese




Prof. dr. Enver Hasani